

VENDIM
Nr.894, datë 21.12.2011

PËR LICENCIMIN E AKADEMISË PEDAGOGJIKE, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e Akademisë Pedagogjike, Tiranë, në emër të shoqërisë “Akademia Pedagogjike e Tiranës” sh.p.k., e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Akademia Pedagogjike, Tiranë të organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i Edukimit, i cili do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, në mësuesi:

i) Cikli parashkollor;

ii) Cikli i ulët;

iii) Gjuhë angleze.

b) Fakulteti i Shkencave Sociale, i cili do të ofrojë programe studimi:

I. Të ciklit të parë në:

i) Pedagogji – histori;

ii) Pedagogji speciale;

iii) “Gazetari”, me profile:

a) Kulturë;

b) Arsim;

c) Shkencë.

II. Të ciklit të dytë “Master profesional”, në:

i) Studime të thelluara në mjeshtëritë e mësimdhënies.

3. Akademia Pedagogjike, Tiranë do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 (tri) vite akademike dhe që realizohen me 180 kredite. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:

i) Mësuesi “Cikli parashkollor”;

ii) Mësuesi “Cikli i ulët”;

iii) Mësuesi “Gjuhë angleze”;

iv) Pedagogji – histori;

v) Pedagogji speciale;

vi) Gazetari, me profile:

a) Kulturë;

b) Arsim;

c) Shkencë.

4. Akademia Pedagogjike, Tiranë do të ofrojë program studimi të ciklit të dytë, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1.5 (një pikë pesë) vit akademik dhe që realizohet me 90 kredite. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “Studime të thelluara në mjeshtëritë e mësimdhënies”.

5. Akademia Pedagogjike, Tiranë ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Akademia Pedagogjike, Tiranë duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në

institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha